



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 43, DATË 29.05.2020

PËR

PËRCAKTIMIN E FREKUENCAVE PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT  
AUDIO ANALOGE DHE ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E LICENCËS TË  
TRANSMETIMIT AUDIO ANALOGE

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, nenit 59 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge në zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit
1.	Qarku Gjirokastrë
2.	Bashkia Sarandë

2. Çeljen e garës për dhënie e licencës së transmetimit audio analoge, për zonën e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarku Gjirokastrë	Audio Analoge Lokale	Përmet	91.6
			Këlcyrë	91.9
			Kërcullë	92.5
			Tepelenë	93.3
2.	Bashkia Sarandë	Audio Analoge Lokale	Kalaja Lëkurs	107.4

3. Miratimin e dokumentacionit të dhënies së licencës private të transmetimit audio analoge, bashkëlidhur këtij vendimi, të përbërë nga: a. licenca e shërbimit të programi audio dhe b. licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.
4. Shpalljen në mënyrë publike të çeljes së procedurës për dhënien e licencës së transmetimit audio.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**